



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-095

Prishtinë, më 28 tetor 2024, ora 11:20
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 TETOR 2024

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Enis Kervan, kryetar i GP Multietnik.

Në mbledhje mori pjesë edhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Stafi përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Seanca plenare e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 26 shtator dhe 10 tetor 2024,
4. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 tetor 2024,
5. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 14 tetor 2024,
6. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024,
7. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 24 tetor 2024,
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
9. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 7 tetor 2024

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 7 tetor 2024.

2. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024

Me kërkesë të kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, përsëri nuk u vendos për datën e mbajtjes së seancës së lartshënuar, me pikën e vetme të rendi të ditës: Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për tre vjet qeverisje.

3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 26 shtator dhe 10 tetor 2024

4. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 tetor 2024

5. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 14 tetor 2024

6. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024

7. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 24 tetor 2024

Kryetari, pas diskutimeve, me konsensus, vendosi që vazhdimi i seancave të lartshënuara në pikat 3 - 7, me pikat e papërfunduara, të mbahet të mërkurën, më 30 tetor 2024, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 26 shtator dhe 10 tetor 2024:

- 5. Votimi për emërimin e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,*
- 6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 7. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-313 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore,*
- 8. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-314 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin Energjia diellore fotovoltaike në KEK – Porta Globale,*
- 9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
- 10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyratë Publike,*
- 11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës,*
- 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët,*
- 13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,*
- 14. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,*

15. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
17. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore,*
18. *Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,*
19. *Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH,*
20. *Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,*
21. *Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,*
22. *Shqyrtimi Projekt-Rezolutës për tërheqjen e tri (3) projektligjeve nga shqyrtimi në Kuvend,*
23. *Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për arratisjen e personave të dënuar – degradimi i institucioneve të sigurisë,*
24. *Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-116,*
25. *Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për vlerësimin e punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022,*
26. *Shqyrtimi i Raportit të Performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2022,*
27. *Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,*
28. *Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre, një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.*

II. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 tetor 2024:

1. *Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Mimoza Kusari - Lila me Milan Radojçiq.*

III. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 14 tetor 2024:

1. *Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për mungesën e ushqimit në Ushtrinë e Republikës së Kosovës.*

IV. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024:

1. *Debat Parlamentar për procesin e përlllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.*

V. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 24 tetor 2024:

1. *Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për skandalet dhe keqmenaxhimi në Korporatën Energjetike të Kosovës.*

8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës, të propozuar për seancë plenare, të miratuar me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 31 tetor 2024, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
2. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
3. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare,*
4. *Propozim-Vendimi për hartimin e Nismës legislative të qytetarëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-295 për krypto-asetet,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues,*
8. *Shqyrtimi i propozimit të gjashtë (6) deputetëve nga GP të PDK-së, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
9. *Zgjedhja e tre (3) drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut,*
10. *Emërimi i anëtarit në Këshillin Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, nga radhët e studentëve,*
11. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-317 për aderim në “Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështje civile apo tregtare”,*
12. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-318 për aderim në “Konventën për marrjen e provave jashtë vendit në çështje civile apo tregtare”,*
13. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-319 për aderim në “Konventën për zgjedhjen e marrëveshjeve gjyqësore”,*
14. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç,*
15. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-315 për banim social dhe të përballueshëm,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor,*
17. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme,*
18. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-316 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,*
19. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim,*
20. *Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur,*
21. *Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-034,*
22. *Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga komuniteti shqiptar,*
23. *Shqyrtimi i Propozimit të shtatë (7) deputetëve nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bahrim Shabani,*

24. *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2023,*
25. *Shqyrtimi i Raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023,*
26. *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2023,*
27. *Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të Arsimit fillor dhe Arsimit të Mesëm të Ulët për vitin shkollor 2023/2024 për periudhën kohore prej 4 korrik 2024 deri në përfundim të mandatit të tij.*

Në lidhje me rendin e ditës të seancës plenare të lartshënuar, me propozim të kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, u radhit pika e lartshënuar nr. 8: Shqyrtimi i propozimit të gjashtë (6) deputetëve nga GP të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Kurse, me konsensus, nuk u radhit pika: Pyetjet parlamentare. Diskutimet në lidhje me pikat e lartshënuara janë dhënë në transkript.

Ndërsa për themelimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, nga pika nr. 22 e lartshënuar, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kuvendit i propozohet themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, sipas dokumenteve të proceduara në Kuvend për dy (2) konkurse:
 - për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, dokumenti Do-2513, datë: 12. 9. 2024, dhe
 - për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, dokumenti Do-2557, datë: 10. 10. 2024.
2. Andaj, kërkohet nga grupet parlamentare që në seancën plenare më 31. 10. 2024 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.
3. Përbërja e Komisionit ad hoc nga pika 1 (një) e këtij Përfundimi do të jetë, si në vijim:
 - GP i LVV-së, kryetarin dhe katër (4) anëtarë;
 - GP i PDK-së, zëvendëskryetarin e dytë dhe një (1) anëtar;
 - GP i LDK-së, dy (2) anëtarë;
 - GP i AAK-së, një (1) anëtar, dhe
 - GP Multietnik, zëvendëskryetarin e parë.
4. Në rast se një grup parlamentar nuk i propozon deputetët për pozitat e kryetarit ose të zëvendëskryetarëve të këtij Komisioni ad hoc, këto pozita do t'u barten grupeve tjera parlamentare, sipas radhës për këto pozita.

9. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Procedimi i nismës legislative të qytetarëve për hartimin e Projektligjit për parandalim të vetëvrasjes

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në pajtim me Ligjin nr. 04/L-025 për nisma legislative, është ndërmarrë nisma legislative nga qytetarët për t'i propozuar Kuvendit hartimin e Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes, ndërsa lista me nënshkrime të 13 626 qytetarëve është dërguar për verifikim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili, pas verifikimit të nënshkrimeve, ka konstatuar se 10 034 nënshkrues të nismës janë qytetarë të Kosovës me të drejtë vote, me këtë janë plotësuar kushtet për procedimin e nismës legislative.

Kryetari dha sqarime ligjore për rastin kur nisma legislative nga qytetarët është në formën e propozimit për hartimin e Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për hartimin e tij konform Rregullores, ose Kuvendi mund të kërkojë nga Qeveria hartimin e Projektligjit, e cila cakton njërin nga ministritë si bartëse për hartimin e tij.

Tutje, kryetari propozoi që pasi Kuvendi do t'i pezullojë punimet në fund të muajit dhjetor 2024, Kryesia t'i propozojë Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria hartimi i Projektligjit për parandalimin e vetëvrasjes.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia e mbështeti propozimin e kryetarit dhe vendosi që Kuvendit t'i propozohet vendimi me të cilin kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë Projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes.

Njëherësh, u vendos që Propozim-Vendimi për hartimin e Nismës legislative të qytetarëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës të radhitet në rendin e ditës të seancës plenare më 31 tetor 2024, pikë nr. 4.

2. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Bahrim Shabani, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bahrim Shabani, i mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Pula (Kroaci), prej datës 17 deri më 20 tetor 2024.

3. Kërkesa e deputetit Pal Lekaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia nuk vendosi për kërkesën e lartshënuar, por në lidhje me pjesëmarrjen e deputetëve në Lutjet Evropiane të Mëngjesit nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Në Lutjet Evropiane të Mëngjesit, të organizuara në Bruksel (Belgjikë), prej datës 3 deri më 5 dhjetor 2024, do të lejohet të marrë pjesë vetëm nga një (1) deputet për secilin grup parlamentar, sipas kërkesave që do t'i adresohen Kryesisë së Kuvendit.

4. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Yllza Hoti, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani, u lejohet udhëtimi zyrtar në Lubjanë (Slloveni), prej datës 2 deri më 4 dhjetor 2024.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të sigurimit shëndetësor për udhëtimin dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e akomodimit mbulohen nga ftuesi - Parlamenti i Sllovenisë.

5. Kërkesa e deputetit Rashit Qalaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rashit Qalaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e vizës, të udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Kërkesa e deputetit Gazmend Gjyshinca për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Deputeti Gazmend Gjyshinca nuk e kishte realizuar udhëtimin zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të paraparë prej datës 19 deri më 28 tetor 2024.

7. Kërkesa e deputetes Jeta Statovci për lejimin e udhëtimit zyrtar në Zvicër

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jeta Statovci, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Zvicër, prej datës 17 deri më 19 tetor 2024.

8. Kërkesa e deputetit Erxhan Galushi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Erxhan Galushi, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Stamboll (Turqi), prej datës 18 deri më 20 tetor 2024.

9. Kërkesa e deputetit Fridon Lala për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fridon Lala, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Bruksel (Belgjikë), prej datës 20 deri më 26 tetor 2024.

10. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Arben Gashi, u lejohet udhëtimi zyrtar në Nju-Jork (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 10 deri më 14 nëntor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Më pas, Kryesia, në lidhje me udhëtimet zyrtare të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me propozim të nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, mori këtë:

V E N D I M

Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me kërkesë të tij do t'i lejohen udhëtimet zyrtare në përbërje me më shumë se dy (2) anëtarë, vetëm për rastet e zëvendësimit të anëtarit që nuk mund të udhëtojë dhe për këto raste Delegacioni e njofton Kryesinë e Kuvendit, ndërsa udhëtimin zyrtar përkatës do ta realizojnë vetëm dy (2) anëtarë.

11. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Greqi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Besnik Tahiri, Enis Kervan dhe Ardian Gola, u lejohet udhëtimi zyrtar në Athinë (Greqi), prej datës 3 deri më 6 nëntor 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

12. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nuk miratohet kërkesa e kryetares së Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024.
2. Për pjesëmarrje në Forumin Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri, që do të mbahet në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024, Kryesia ka vendosur që të lejohet vetëm nga një (1) deputet për secilin grup parlamentar, ndërsa nga GP i PDK-së është lejuar deputeti Rashit Qalaj.

13. Kërkesa e deputetes Ariana Musliu-Shoshi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nuk miratohet kërkesa e deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024.
2. Për pjesëmarrje në Forumin Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri, që do të mbahet në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 2 deri më 6 dhjetor 2024, Kryesia ka vendosur që të lejohet vetëm nga një (1) deputet për secilin grup parlamentar, ndërsa nga GP i PDK-së është lejuar deputeti Rashit Qalaj.

14. Kërkesa e deputetit Gazmend Gjyshinca për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nuk miratohet kërkesa e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazmend Gjyshinca, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Lubjanë (Slloveni), prej datës 26 deri më 29 nëntor 2024.

15. Kërkesa e deputeteve Blerta Deliu-Kodra dhe Hykmete Bajrami për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për udhëtimin zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra dhe Hykmete Bajrami, u mbulohen shpenzimet e akomodimit për një (1) natë në Aeroportin e Stambollit dhe shpenzimet për shërbimet e taksisë, me paradhënie në shumën prej 1 000 euro, nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Uashington D.C. (Shtete të Bashkuara të Amerikës), prej datës 20 deri më 27 tetor 2024.

16. Kërkesa e deputetes Ariana Musliu-Shoshi për mbulimin e shpenzimeve të biletës së udhëtimit nga udhëtimi zyrtar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi dhe nëpunëses së Administratës së Kuvendit, Arjeta Statovci, u mbulohen shpenzimet në shumën nga 125,00 euro për secilën, për ndryshimin e biletave të kthimit Basel - Prishtinë, nga udhëtimi zyrtar i realizuar nga data 29 shtator deri më 5 tetor 2024.

17. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci për mbulimin e shpenzimeve të biletës së udhëtimit nga udhëtimi zyrtar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetares së Kuvendit / kryesueses së Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Saranda Bogujevci, i mbulohen shpenzimet në shumën prej 310,00 euro për biletën e kthimit në Mançester, nga udhëtimi zyrtar i realizuar nga data 29 shtator deri më 2 tetor 2024.

18. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për mbulimin e shpenzimeve shtesë nga udhëtimi zyrtar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës i mbulohen shpenzimet shtesë të bëra në udhëtimin zyrtar të realizuar në Strasburg (Francë), prej datës 29 shtator deri më 5 tetor 2024, gjatë pjesëmarrjes në Sesionin Vjeshtor të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, sipas kërkesës nr. 08/5795/Do-2556, datë 10. 10. 2024 dhe nr. 08/5845/Do-2588, datë 24. 10. 2024, si vijon:

- Shuma prej 605,00 euro (sipas faturës), për transportin me taksi; dhe
- Shuma prej 426,00 euro (sipas faturës), për një drekë të përbashkët me delegacionet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

19. Kërkesa e deputetëve Xhavit Haliti dhe Hisen Berisha për mbulimin e shpenzimeve për tejkalimin e shpenzimeve të akomodimit nga udhëtimi zyrtar në Hungari

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës: Xhavit Haliti dhe Hisen Berisha, si dhe nëpunëseve të Administratës së Kuvendit: Zarë Aliu dhe Zana Grubi, u mbulohen tejkalimet e shpenzimeve të akomodimit, në udhëtimin zyrtar të realizuar në Budapest (Hungari), prej datës 8 deri më 11 shtator 2024, sipas kërkesës nr. 08/5838/Do-2581, datë 22. 10. 2024, si vijon:

- Shuma prej 205,89 euro, për deputetit Xhavit Haliti,
- Shuma prej 206,33 euro, për deputetin Hisen Berisha,
- Shuma prej 222,75 euro, për nëpunësen Zarë Aliu, dhe
- Shuma prej 222,75 euro, për nëpunësen Zana Grubi.

20. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 99,40 euro (sipas faturës) të drekës zyrtare të shtruar nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për kreun e Misionit të Ambasadës së Dukatit të Madh të Luksemburgut, më 20. 9. 2024.

21. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të drekës zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike i lejohen shpenzimet për një drekë zyrtare të përbashkët me Nënkomisionin për Auditimin e Sektorit Publik të Kuvendit të Shqipërisë, me rastin e vizitës zyrtare në Kosovë, më 1 nëntor 2024.

2. Shuma e shpenzimeve për drekën zyrtare nga pika një (1) e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Në fund, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci e shtroi çështjen e rëndësisë së sigurimit të biletave të udhëtimeve me avion për udhëtimet zyrtare të delegacioneve të Kuvendit për rastet e nevojave për shtyrje të udhëtimeve ose të anulimeve të udhëtimeve.

Diskutimi i plotë i nënkryetares së Kuvendit, znj. Bogujevci, është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar diskutoi edhe kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 11:55 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale